



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

AKT NORMATIV

Nr._____, datë _____

PËR

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.109/2017, “PËR BUXHETIN
E VITIT 2018”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Nenet 1, 2, 3, 4 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2018 është:

Të ardhurat	461 865	milione lekë;
Shpenzimet	494 231	milione lekë;
Deficiti	32 366	milione lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2018 është:

Të ardhurat	348 717	milione lekë;
Shpenzimet	381 083	milione lekë;
Deficiti	32 366	milione lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2018 është:

Të ardhurat	49 620	milione lekë;
Nga të cilat:		
- transferta e pakushtëzuar nga buxheti qendror	16 600	milione lekë;
- transferta specifike	7 454	milione lekë;
- të ardhura të tjera	25 566	milione lekë;
Shpenzimet	49 620	milione lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2018 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror:

Të ardhurat, gjithsej	121 551	milione lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	77 160	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	39 646	milione lekë;
- transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	1 445	milione lekë;
- transferta për bonusin e pensionistëve	3 300	milione lekë
Shpenzimet	121 551	milione lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2018, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar:

Të ardhurat, gjithsej	5 809 milionë lekë;
Nga të cilat:	

- | | |
|--------------------------------------|---------------------|
| - kontributet | 1 376 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit | 4 333 milionë lekë; |
| - fondi për indeksimin e pensioneve | 100 milionë lekë; |

Shpenzimet	5 809 milionë lekë.
------------	---------------------

Fondi për indeksimin e pensioneve është 1 545 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 550 milionë lekë dhe janë të ndara sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	12 000 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	310 959 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	25 757 milionë lekë”.

Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- | | |
|-------------------------------------|-----------------------|
| - Shpenzime të buxhetit qendror | 375 583 milionë lekë; |
| - Fondi rezervë | 1 500 milionë lekë; |
| - Kontingjencë për risqet e borxhit | 4 000 milionë lekë.”. |

b) Tabelat 1 dhe 4, të përmendura në nenin 10, zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ dhe janë pjesë përbërëse të tij. Shtesa e grantit prej 300 milionë lekësh në programin e arsimit të lartë përdoret për përmirësimin e kushteve në konviktet e studentëve të Bashkisë Tiranë.

Neni 3

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Fondi rezervë i buxhetit prej 1 500 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave, për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekësh përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.”.

Neni 4

Tabela 3, që përmendet në nenin 16, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij akti normativ dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

SENIDA MESI

**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

ARBEN AHMETAJ